



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT**

Nr. 915/prot.
1

Tiranë më 19.06.2018

VENDIM

Nr. 25, datë 19/16 /2018

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesi Z. ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim quajtur “Komisioneri”) ankesën nr. 915 Prot., datë 22.05.2018, ndaj Autoritetit Publik “Bashkia Tiranë” (në vijim quajtur “Autoriteti Publik”), me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare”.

Ankuesi, me shkresën e datës 01.05.2018 ka kërkuar nga Autoriteti Publik t’i vihet në dispozicion informacioni dhe dokumentacioni si më poshtë:

1. Projektin fillestar të planifikimit të zonave ku do të bëhej mbjellja e pemëve. Sipërfaqja e plotë, sipërfaqja për secilën zonë të Tiranës bashkë me hartat përkatëse dhe numrin e fidanëve për çdo zonë.
2. Koston e plotë të operacionit dhe aktin e prokurimit duke përfshirë çmimin për njësi (fidanë) që është përdorur për pyllëzimin e Tiranës.
3. Emrat e donatorëve të ndryshëm që janë bërë pjesë e projektit dhe të dhënat konkrete për çdo donacion - numrin e fidanëve që janë dhuruar, apo kundërvleftën në lekë për secilin donacion zbërthyer - për numër fidanësh.
4. Llojin e fidanëve të përdorur - pishë, kumbull e kuqe etj... - numrin e përgjithshëm për secilin lloj dhe vlerën përkatëse në lekë.
5. Sipërfaqen e plotë në total të zënë nga mbjellja e 120 mijë pemëve në mbarë hapësirën e Tiranës.

Pas refuzimit të dhënies së informacionit nga Autoriteti Publik, ankuesi kërkon nga Komisioneri, ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit nga Autoriteti Publik.

Me e-mailin, datë 28.05.2018, Komisioneri i ka kërkuar Autoritetit Publik të trajtohet kërkesa dhe të vlerësohet dhënia e informacionit të kërkuar brenda datës 04.06.2018. Megjithëse ka kaluar afati i përcaktuar për dhënien e informacionit, Autoriteti Publik nuk ka kthyer përgjigje.

Pas shqyrtimit të ankesës, si dhe konsultimit të legjislacionit përkatës rezulton se, informacioni i kërkuar në pikat 1, 2, 4 dhe 5 të objektit të kërkesës më sipër, përmbush kërkesat e pikës 2, të nenit 2, të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i cili përcakton se: *“Informacion publik” konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik*”.

Sa i përket informacionit të kërkuar në pikën 3, në rastin e donatorëve individë, informacioni mund të bëhet publik nga ana e Autoritetit Publik vetëm në rast se ky i fundit disponon pëlqimin e tyre lidhur me bërjen publik të identitetit të tyre. Kjo qasje imponohet nga kriteret e përcaktuara në nenet 5, 6 dhe 7 të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar.

Bazuar në nenin 15 të Ligjit Për të Drejtën e Informimit, Autoriteti Publik trajton kërkesën për informim, duke parashtruar informacionin e kërkuar sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se 10 ditë pune nga dita e dorëzimit të saj, përveç rasteve kur ligji i posaçëm parashikon ndryshe. Për sa më sipër, konstatohet se Autoriteti Publik nuk e ka përmbushur detyrimin për të informuar kërkuuesin.

Bazuar në pikën 3 të nenit 3 të ligjit sipërcituar, *“Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit”*.

Theksojmë, se e drejta për t’u informuar është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

Në këto kushte, në lidhje me ankesën e Z. ndaj Autoritetit Publik “Bashkia Tiranë”, Komisioneri vlerëson se ankesa është e bazuar në ligj dhe si e tillë ajo duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5, të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18, të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative” dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”,

VENDOSA:

1. Pranimin e ankesës së Z. _____, Nr. 915 Prot., datë 22.05.2018, ndaj Autoritetit Publik/Bashkia Tiranë, me objekt "Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare".
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik/Bashkia Tiranë për vënien në dispozicion të informacionit/dokumentacionit të kërkuar, konkretisht:
 - Projektin fillestar të planifikimit të zonave ku do të bëhej mbjellja e pemëve. Sipërfaqja e plotë, sipërfaqja për secilën zonë të Tiranës bashkë me hartat përkatëse dhe numrin e fidanëve për çdo zonë.
 - Koston e plotë të operacionit dhe aktin e prokurimit duke përfshirë çmimin për njësi (fidanë) që është përdorur për pyllëzimin e Tiranës.
 - Emrat e donatorëve të ndryshëm që janë bërë pjesë e projektit dhe të dhënat konkrete për çdo donacion - numrin e fidanëve që janë dhuruar, apo kundërvleftën në lekë për secilin donacion zbërthyer - për numër fidanësh, përsa kohë ato janë persona juridik ose fizik në kuptim të Ligjit nr. 9901 datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar, dhe në rastin e donatorëve individë, përsa kohë ata kanë dhënë pëlqimin për bërjen publik të identitetit të tyre.
 - Llojin e fidanëve të përdorur - pishë, kumbull e kuqe etj., - numrin e përgjithshëm për secilin lloj dhe vlerën përkatëse në lekë.
 - Sipërfaqen e plotë në total të zënë nga mbjellja e 120 mijë pemëve në mbarë hapësirën e Tiranës, brenda datës 26.6.2018.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi, sipas nenit 25 të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit".
4. Ky vendim u shpall sot në datë 19.6.2018.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

